



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-04

**Vendosi:** **Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit**  
Gjykatëse Mishelë Pikar  
Gjykatës Emilio Gati  
Gjykatëse Nina Jorgensen

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 28 tetor 2021

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendim mbi Kërkesën e Shalës për Ndryshim Afati**

---

**Zyrës së Prokurorit të Specializuar:**

Xhek Smith

**Mbrojtësit të Pjetër Shalës:**

Zhan-Lui Zhilisen

**PANELI I DHONËS SË GJYKATËS SË APELIT** të Dhomave të Specializuara të Apelit (përkatësisht „Paneli i Gjykatës së Apelit“ ose “Paneli i Apelit” ose “Paneli” dhe “Dhomat e Specializuara”),<sup>1</sup> bazuar në nenin 33(1)(c) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullën 169 të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), ka marrë në shqyrtim kërkesën e parashtruar nga Pjetër Shala (përkatësisht “Kërkesa” dhe “Shala”)<sup>2</sup> për zgjatjen e afatit për të apeluar kundër “Vendimit mbi Mocionin që ngre Kundërshtime lidhur me Themelimin dhe Juridiksionin e Dhomave të Specializuara” të Gjykatësit të Procedurës Paraprake (përkatësisht “Apeli” dhe Vendimi i Kundërshtuar”).<sup>3</sup> Shala kërkon një zgjatje prej dhjetë ditësh për paraqitjen e apelit, pra deri më 8 nëntor 2021.<sup>4</sup>

1. Shala parashtron se ekzistojnë arsye të vlefshme për miratimin e ndryshimit të afatit.<sup>5</sup> Së pari ai parashtron se, pavarësisht ushtrimit të zellit të duhur, përkimi i pesë afateve kryesore që bien ndërmjet datave 26 tetor dhe 5 nëntor 2021 do të thotë se “Mbrojtja është nën presion të konsiderueshëm të shkaktuar nga një zinxhir ngjarjesh dhe vonesash procedurale për të cilat ajo nuk është përgjegjëse”.<sup>6</sup> Së dyti, Shala argumenton se për shkak të një ndryshimi kohët e fundit në përbërjen e ekipit të tij të Mbrojtjes, ky i fundit nuk mund të jetë plotësisht funksional.<sup>7</sup> Së fundmi, ai parashtron se Apeli përmban probleme të rëndësishme, komplekse dhe të reja, të cilat përbëjnë një pjesë thelbësore të çështjes së Mbrojtjes, dhe se Zyra e Prokurorit të Specializuar

---

<sup>1</sup> F00001, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit për Shqyrtimin e një Kërkesë për Zgjatje Afati, 28 tetor 2021.

<sup>2</sup> F00096, Kërkesë e Mbrojtjes për Zgjatjen e Afatit të Apelimit të “Vendimit mbi Mocionin që Ngre Kundërshtime lidhur me Themelimin dhe Juridiksionin e Dhomave të Specializuara”, 27 tetor 2021 (“Kërkesa”).

<sup>3</sup> F00088, Vendim mbi Mocionin që Ngre Kundërshtime lidhur me Themelimin dhe Juridiksionin e Dhomave të Specializuara, 18 tetor 2021 (“Vendimi i Kundërshtuar”).

<sup>4</sup> Kërkesa, para 3, 12.

<sup>5</sup> Kërkesa, para 4.

<sup>6</sup> Kërkesa, para 5-7.

<sup>7</sup> Kërkesa, para 8.

(“ZPS”) nuk do të paragjykohet, duke qenë se ka bërë të ditur se nuk do ta kundërshtojë Kërkesën.<sup>8</sup>

2. Paneli vëren se, sipas rregullës 170(1) të Rregullores, palët duhet t’i paraqesin apelet kundër Vendimit të Kundërshtuar deri më 29 tetor 2021.<sup>9</sup> Paneli tërheq vëmendjen gjithsesi se rregulla 9(5)(a) e Rregullores lejon ndryshimin e çdo afati të parashikuar në Rregullore në rast të paraqitjes së një arsyeje të vlefshme ose *proprio motu*.

3. Paneli i Apelit vëren rëndësinë dhe kompleksitetin e problemeve të trajtuara në Vendimin e Kundërshtuar, si dhe risinë e kësaj çështjeje para Panelit. Është pranuar më parë se këta faktorë përbëjnë arsye të vlefshme për ndryshimin e afateve për paraqitjen e apeleve, duke justifikuar një devijim nga afatet e përcaktuara në Rregullore.<sup>10</sup> Në këtë aspekt, Paneli rikujton se është në interesin e drejtësisë që palët të bëjnë parashtrime kuptimplota në apelet para Dhomave të Specializuara, të ngjashme me problemet e ngritura në Vendimin e Kundërshtuar.<sup>11</sup> Paneli i Apelit gjithashtu vëren vështirësitë që krijohen nga ndeshjet e afateve me të cilat po përballet aktualisht ekipi i Mbrojtjes së Shalës.<sup>12</sup> Për këtë arsye Paneli konstaton se, nën dritën e argumenteve të përmendura më lart ekzistojnë arsye të vlefshme për miratimin e ndryshimit të afateve për Apelin.

---

<sup>8</sup> Kërkesa, para 9-10.

<sup>9</sup> Ndonëse u lëshua më 18 tetor 2021, Vendimi i Kundërshtuar u njoftua ditën e nesërme, më 19 tetor 2021.

<sup>10</sup> KSC-BC-2020-06, F00004, Vendim mbi Kërkesat e Thaçit dhe Krasniqit për Ndryshimin e Afatit dhe Numrit të Lejuar të Fjalëve, 27 tetor 2021 (“Vendim mbi Ndryshimin e Afatit dhe Numrit të Lejuar të Fjalëve”), para. 7.

<sup>11</sup> Vendim mbi Ndryshimin e Afatit dhe Numrit të Lejuar të Fjalëve, para. 7.

<sup>12</sup> Shih p.sh. ICC, *Prosecutor v. Ruto and Sang*, ICC-01/09-01/11-1970, Decision on Page and Time Limits for the ‘No Case to Answer’ Motion, 18 September 2015, para. 20; ICC, *Prosecutor v. Blé Goudé*, ICC-01/11-02/11-205, Decision on Prosecution request for extension of time and on the response deadline for ICC-02/11-02/11-204, 30 January 2015, paras 7, 9; STL, *Prosecutor v. Ayyash et al.*, STL-11-01/T/AC/AR126.7, Order by Judge Rapporteur on Request for Extension of Time and Word Limits, 4 April 2014, para. 3.

4. Së fundmi Paneli rikujton se, sipas rregullës 9(6) të Rregullores, mocionet për ndryshimin e afateve mund të miratohen pa u dhënë palëve mundësinë që të dëgjohen. Duke mbajtur parasysh se po afrohet afati për paraqitjen e Apelit, dhe duke qenë se ZPS ka bërë të ditur se nuk do të kundërshtojë Kërkesën dhe rrjedhimisht nuk do të ketë paragjykim ndaj palëve, Paneli konsideron se është në interesin e drejtësisë që të miratojë menjëherë Kërkesën.

5. Për këto arsye, Paneli i Gjykatës së Apelit:

**MIRATON** Kërkesën; dhe

**AUTORIZON** Shalën që të paraqesë Apelin e tij jo më vonë se 8 nëntor 2021.

\_\_\_\_\_  
/nënshkrim/

**Gjykatëse Mishelë Pikar,  
Kryegjykatëse**

E enjte, 28 tetor, 2021

Në Hagë, Holandë